



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:099538

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557973

**P.nr.154/2007**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**, Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Ali Kutllovci, antarët e trupit gjykues- gjyqtarët: Mentor Hajra dhe Valon Hajdini , me zyrtaren ligjore Shukrije Selimi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V.A, për shkak të vepres penale: Vrasje nga neni 30 pika 3 e LPK-së , lidhur me nenin 22 të LPJ-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr.85/2002 të dt. 29.05.2002.Gjykata pas mbajtjes dhe perfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.07.03.2024, i cili ishte i hapur për publikun, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit Njazi Rexha , i pandehuri V.A, mbrojtësi me autorizim av.Vehbi Beqiri me datën 11.03.2024 ka marrë dhe publikisht në prezencen e të pandehurit dhe mbrojtësit të tijë e në mungesë të prokurorit të shtetit, ka shpallur, ndërsa me datë 08.04.2024, ka përpiluar me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit ;

**V.A**, nga i ati B..., e ëma M..., e vajzërisë-B..., “data e lindjes”, në fshatin M...-Komuna e Mitrovicë ku edhe jeton , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës ,me nr personal, puntorë në inspekcion në Komunë Mitrovicë, ka të kryer SHMT-dega e ndertimtarisë , i martuar, baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së varfer ekonomike i pa denuar, ndaj tij nuk udhëhiqet procedur penale.Në masen e paraburgimit ka qëndruar nga data 09.03.2002 e deri më dt. 10.10.2003.

Gjykata duke u bazua në dispozitat e nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së:

### **LIROHET NGA AKUZA**

**Sepse:**

Me dt 03.03.2002 rreth orës 06.00, në vednin e quajtur ‘‘Lugu i birrave’’ te fshati M... Komuna e Mitrovicës, sipas marveshjes paraprake, në bashkveprim në mes vete dhe me personin akoma të pavertetuar, për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, për shkak të konflikteve të mëparme verbale, fizike dhe të armatosura, me dashje kanë privuar nga jeta tani të ndjerin H.A, në atë mënyrë që duke e ditur kohën e shkuarjes së tij në punë dhe rrugën nëpër të cilën kalon, të armatosur e kanë pritë në pusi, dhe kur tani i ndjeri ka kaluar aty pari dhe i ka anashkaluar; I pandehuri V.A, pasi që tani i ndjeri është rrëzuar në shpinë për toke, iu ka ofruar dhe nga brezi i të ndjerit ja ka nxjerrë revolen e markes ‘‘ Tokarev’’ të kalibrit 7.62 x25 mm me numer serik H 109365 me të cilën ka shtënë dy her në koken e tijë.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Vrasje nga neni 30 al 2 pika 3 të LPK e lidhur me nenin 22 të LPJ

Lidhur me konfiskimin e armëve trupi gjykues konstaton se armët janë konfiskuar me Aktgjykimin P.nr.145/05 dt. 30.10.2006.

I akuzuari lirohet në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale për këtë rast.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

## **A r s y e t i m i**

### ***Aktakuza- rasti :***

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën, PP.nr.85/2022 të dt. 29.05.2002 kundër të akuzuarve F.A dhe V.A, për shkak të vepres penale: Vrasje nga neni 30 pika 3 e LPK-së , lidhur me nenin 22 të LPJ-së

### ***Rrjedha e procedures:***

Me dt.22.07.2022, kjo lëndë penale më është caktuar për procedim. Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të lëndës ka konstatuar se lënda është e kthyer në rivednosje dhe se sipas aktakuzës PP nr 85/02 dt. 29.05.2002 ishin akuzuar dy vllëzërit F.A dhe V.A për veprën penale Vrasje nga neni 30 pika 3 e LPK-së , lidhur me nenin 22 të LPJ-së.

Gjykata gjeti se F.A me aktgjykimin P.nr.141/05 dt. 30.10.2006, i akuzuari i parë në këtë çështje F.A eshte shpallur fajtor dhe është denuar me denim me burgim në kohzgjatje prej 10 vite. Ndërsa i akuzuari V.A eshte liruar nga akuza.

Me aktgjykimin e Gjykates Supreme te Kosoves me nr. AP.nr. 26/07 dt. 15.03.2007 lidhur me te akuzuarin F.A eshte ndryshuar Aktgjykimi P nr. 141 /05 dt. 30.10.2006 ashtu qe ky i akuzuar

është dënuar me 20 vite burgim të cilin denim e ka vuajtur i pandehuri F.A. Lidhur me te pandehurin V.A aktgjykimi i cituar është prishur dhe çështja është kthyer ne rigjykim me arsyetimin se ;

-Nuk ka arsyetim pse nuk është deklaruar në seancën kryesore dëshmitari anonim.

-Arsyet e shmangies së ekspertizës së ekspertit kompetent për dylbi për identifikimin e personave dhe veprimeve të tyre të cilat qëndronin në vendin e ngjarjes kur u privua nga jeta tani i ndjeri, nga vendi ku qëndronte dëshmitari anonim.

Me rekomandimin se në rigjykim gjykata duhet ti vlersoj provat veç e veç, në lidhmëri me njëra tjetrën, mbrojtjen e të akuzuarit, deklaratën e dëshmitarit anonim duke u kujdesur të mos zbulohet anonimiteti i tij. Pastaj të kërkohet nga dëshmitari anonim dorzimi i dylbive që i ka përdorur ditën kritike, me të cilat sipas deklaratimit të tij, ka identifikuar të akuzuarit gjatë privimit të jetës tani të ndjerit. Nëse dylbit nuk mund të sigurohen atëherë të kërkohet nga dëshmitari anonim shpejgim plotësues lidhur me llojin e dylbive të përdorura dhe karakteristikat e tij.

Të del në vendin e ngjarjes me ekspert nga lëmia e optikës të institutit të forenzikës me qëllim të vërtetimit të faktit se a ekziston apo jo mundësia që nga vendi që ka qëndruar dëshmitari anonim të identifikohen personat dhe veprimet që i kanë ndërmarrë ata sipas deklaratës së dëshmitarit anonim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për krime të rënda, në këtë çështje penale, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.11.05.2023;19.10.2023;04.12.202305.03.202407.03.2024, në të cilat shqyrtime kanë prezantuar prokurori i shtetit Njazi Rexha , i pandehuri me mbrojtësin e tij.

Perfaqesuesi i pales së dëmtuar , mbrojtësi i viktimave po ashtu edhe dëshmitarët: H.A1 , dëshmtari anonim "T..." , J.Z, G.H dhe A.T ndersa dëshmitarët Z.A, F.A, H.A3 është konstatuar se të njëjtit kanë vdekur , Gjykata në pajtim me dispoziten e nneit 335 par 1 nenpar 1.1 të KPP-së ka nxjerr aktvendim në senacen e dt. 19.10.2023 dhe i ka lexuar deklaratat e tyre.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun përveq sences së dt. 19.10.2023 në pjesen ku është proceduar dëshmtari anonim "T..." i cili është i shpallur si dëshmtar anonim dhe i njëjti është proceduar nga një vendë i mbyllur në gjykatore i padukshëm dhe të cilit i është ndrruar zëri për t'ë mos u identifikuar.

Shpallja publike e aktgjykimit është bërë me dt.11.03.2024, në prezencën e të pandehurit me mbrojtësin e tij e në mungesë të prokurorit të shtetit.

Në shqyrtim gjyqësor pasi që gjykata të akuzuarin e njoftoj me pasojat dhe beneficionet që parashihen me ligj e të cilat kanë të bëjnë lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtim

gjyqësor, i akuzuari pas konsultimit edhe me mbrojtësin e tij u deklarua i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

***Fjala përfundimtare e palëve:***

***Prokurori i shtetit Njazi Rexha në fjalën përfundimtare*** ka deklaruar se: gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar dëshmitart, është dëgjuar dëshmtari anonim “T...”, dëshmitarët J.Z, I.A, eksperti F.R dhe është bërë administrimi i provave materjale dhe meqense nga krejt këto nuk ka ndryshime në gjendjen faktike mbes pranë fjales përfundimtare të dt.26.10.2006.

***Mbrojtësi i viktimave në fjalën përfundimtare deklaron: qëndrojmë pran fjales përfundimtare te prokurorit të shtetit.***

***Mbrojtësi i të pandehurit V.A, av. Vehbi Beqiri*** , në fjalën përfundimtare deklaron: meqense lënda është e vitit 2002, unë fjalën përfundimtare e kam përgaditur me shkrim të cilën ja dorzoi gjykatës dhe e elaboroi me gojë.

***I pandehuri V.A në fjalën përfundimtare*** deklaron se qëndron pran fjales përfundimtare te mbrojtësit te tije dhe nuk kam çka te shtojë.

***Provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor;***

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.11.05.2023,në këtë çështje penale ka administruar këto prova: në cilësinë e të dëshmitarit ka dëgjuar : H.A1.

Në sencen e dt. 19.10.2023 në cilsin e dëshmtarit e ka dëgjuar dëshmtarin anonim “T...” nën masat e percaktuara duke e mbyllur në një zyre të veçant i pa dukshëm për publikun dhe duke ja ndryshuar zerin komplet me qëllim të mos identifikimit nga të pranishmit.

Në sencen e dt. 04.12.2023 është dëgjuar dëshmtari J.Z dhe janë administruar provat materjale.

Në séancen e dt. 04.12.2023, Gjykata i ka njoftuar palët se bazuar në rekomandimin e Gjykatës Supreme të Kosovës që të del në vendin e **ngjarjes me ekspert nga lëmia e optikës të institutit të forenzikës** me qëllim të vërtetimit të faktit se a ekziston apo jo mundësia që nga vendi që ka qëndruar dëshmitari anonim të identifikohen personat dhe veprimet që i kanë ndërmarrë ato sipas deklaratës së dëshmitarit anonim, gjykata ka kontaktuar me Institutin e forenzikes dhe nga i njëti ka marr përgjigjen se nuk kanë ekspert të kësaj fushe .

Prokurori i shtetit ka propozuar që të gjendet një ekspert jashtë shtetit me qëllim të kryerjes së këtij veprimi me arsyetimin se sipas njohurive departamenti për bashkpunim juridik nderkombëtar ka marveshje me Institutin e Bazelit dhe të provohet se a mundet të sigurohet një ekspert i kësaj fushe, pra ekspert i optikës.

Gjykata ka kontaktuar me Departamentin për bashkpunim juridik nderkombëtar por nuk ka marr përgjigje se a mundë të sigurohet një ekspert i tillë .

Gjykata ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të marrë informata lidhur me sigurimin e një eksperti të Optikës dhe në kontakt me eprorin M.Sh epror i "Njisisë special intervenuese " si njësi elitare e Policisë së Kosovës nga i cili ka marr përgjigjen se ekziston Njësiti përkatës në policinë e Kosovës i specializuar për snajper dhe është pikrisht kjo fushë adekuate dhe nga i njëjti është kërkuar që ti specifikoi dy zyrtar të këtij Njësiti me detyrë për t'ju përgjigjur kërkesave të Gjykatës.

Në sencen e dt. 05.03.2024 Trupi gjykues ka dalur ne vendin e ngjarjes në fshatin M... në rikonstruimin e vendit të ngjarjes për ta përcaktuar eksperti se me të vertet përmes dylbive të siguruara me optiken 8x30 dhe 16x32 a mundë të bëhet identifikimi i personit nga kjo distance . Bazuar në këto rrethana në sencen e dt. 05.03.2024 , trupi gjykues ka kërkuar nga prokurori që të deklarohet rreth faktit se i njëjti kishte propozuar një ekspert nga jashtë vendit dhe meqense nuk ka mundur të sigurohet tani të deklarohet rreth mundësis që për ekspert të angazhohet nga Njësiti i specializuar i snajperistve e që është lëmia e Optikës ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 133 dhe 136 të KPP-së.

Meqense eksperti i kësaj njësie të snajperistve ishte ftuar në sences e kësaj date , nga i njëjti u kërkuar të prezenton përvojën dhe trajnimet e kryera më të avancuara në këtë fushë i cili deklaroi se ne si operator kemi trajnime te vazhdueshme me njësit më elitare botrore nga SHBA-të , nga Turqia, Italia, Gjermania etj dhe gjithëher jemi pjesmarrës në trajnime të avancuara së bashku me këto shtete , gjithashtu në të dy që jemi këtu jemi edhe Inspektor të optikave dhe snajperëve në policinë e Kosovës.

Pas kësaj Prokurori deklaroi se duke u gjendur ne një situatë të tillë dhe meqense gjatë gjurmimeve Gjykata ka gjetur se ne Policinë e Kosovës ekziston njësiti i specializuar i optikës i cili mundë të na ndihmoi në rastin konkret nuk e kundërshtojmë që si ekspert të mirret nga ky njësiti.

Gjykata bazuar në dispozitën e nenit 133 par 1 të KPP-së ku përcakton se; Me qëllim të ndriçimit dhe vërtetimit të fakteve relevante në procedurë penale mund të angazhohen persona të cilët në bazë të kualifikimit të tyre profesional ndihmojnë organet që zhvillojnë procedurën penale:

1.2. eksperti duhet të ketë përvojë ose trajnim të specializuar që është relevant dhe aktual;

1.4. gjatë ekspertizës, eksperti duhet të ketë përdorur praktika përgjithësisht të pranuar në fushën e tij ose të ketë bazë shkencore apo teknike;

Bazuar në këtë dispozit ligjore dhe në faktin se pjestari i Njësitetit përkatës është i trajnuar në këtë fushë dhe është instructor i kësaj fushe dhe se i njëjti ka ndjekur trajnimet më të avancuara me njësitet më elite të SHBA-ve dhe shteteve të Europës, GjykJata ka marr aktvendim që si ekspert ka angazuar ekspertin e fushes së optikes nga Njësiti i snajperistve në kuader të policisë së Kosovës. Trupi gjykues të njëjten ditë ka vendosur meqenëse ishin bërë përgaditjet , për të dal në vendin e ngjarjes në fshtin M... ku kishte ndodhur rasti me 03.03.2002. Në vazhdim të procesverbalit të shtetit Trupi gjykues ka vazhduar procesverbalin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes duke dal në vendin e ngjarjes me pjesëmarrjen e prokurorit , policisë së Kosovës , forenzikës, të pandehurit , avokatin e tij . Ndersa dëshmitari anonim ‘‘T...’’ nën masat e policisë është dërguar në vendin ku ai ka pretenduar se ka qenë kur ka shikuar me dylbi. Në anën tjetër është vendosur zyrtari nga policia e Kosovës pjestar i Njësitetit të specializuar që ka punuar bashkë me ekspertin. Vlen të ceket se janë siguruar dylbit të cilat janë cek në shkresat e lëndës po ajo dioptri që është përdor edhe menjher pas ngjarjes me rastin e rikonstruimit nga trupi i atëhershëm gjykues pra dylbit 8x30 dhe dylbit 16x32 .

Janë fiksuar pikat ku ka qenë dëshmitari i mbrojtur me dylbi të vedni i quajtur ‘‘Qurshiat e Kurtit’’ dhe vendi i quajtur ‘‘Lugu i birrave’’ ku ka ndodhur vrasja. Rekonstrimi i vendit të ngjarjes është incizuar me audio dhe video nga zyrtari i forenzikës me kamer të llojit ‘‘Soni’’ .

Faktet e përcaktuara për tu vertetuar ishin ; a mundë nga vendi i quajtur ‘‘ Qershia e Kurtit’’ duke e bërë shiqimin në drejtim të vendit të ngjarjes ‘‘ Lugu i birrave’’ të identifikohet saktësisht personi-individi zyrtari policor V.K –zyrtar i njësitetit të snajperistve , në një distancë sipas ekspertit diku 1.100 metra në vijë ajrore , e më saktësisht fytyra e tijë.

Eksperti pasi që është paralamruar me detyrimet nga neni 122par 2 të KPP-së , pas kësaj nga eksperti është kërkaur që konkretisht përmes dylbive 8x30 të koncentrohet –pozicionohet që të bëjë shiqimin dhe të përcaktoj se a mundet të identifikoj kolegun zyrtarin V.K që gjendet në vendin e quajtur ‘‘Lugu i birrave’’ në një largësi prej përafersisht 1.00 metra në vijë ajrore siç e përcakton eksperti nga ky vendë –pozicion.

Eksperti F.R , përmes dylbive të llojit 8x30 , deklaroi se jo nuk është e mundur të bëhet identifikimi i kolegut tonë V.K edhe pse është i njohur për mua sepse është koleg i imi , nuk mundë të vrehet fytyra dhe as çka ka në duar, sepse kolegu më pyeti përmes telefonit se çka kam në duar dhe unë nuk po mundem ta vrej se çka ka në duar.Ngjyra e rrobeve nuk mundë të

përcaktohet vetëm në vija të trasha mundë të duken rroba të mbyllta. Si trup mundë të shihet edhe kur ulet dhe ngritet bazuar në faktin se tani dukshmëria është shumë e lartë , ndersa në mëngjes siq thuhet në ora 6 të mëngjesit kur ka ndodhur rasti ka qene shumë vështirë të identifikohen lëvizjet e personit.

Trupi gjykues ka kerkuar nga eksperti që që nga kjo pikë të provoi me dylbi tjera më të avancuara me optikë 16x32 për të vërtetuar s ea mundë të bëhet identifikimi i personit edhe pse optika e këtyre dylbive është më e avancuar.

Eksperti ka deklaruar se prap se prapë nuk është e mundur të identifikohet edhe pse janë më të avancuara dylbit për kah shiqimi. Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se a mundë të identifikohet kolegu juaj në vendin ku është pozicionuar përgjigjet se nuk mundë të identifikohet. Gjykata pas verifikimit dhe sigurimit të certifikatave të vdekjes bazuar ne nenin 335 par 1 nënpar 1.1 të KPP-së ka marr aktvendim dhe ka lexuar procesverbalet e deklarimit te dëshmitarve ; Z.A, F.A, H.A3

### ***Procedimi i dëshmitareve ne shqyrtim gjyqësor:***

*1.Dëshmitari – H.A1* , është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 11.05.2023, i njejt i në dëshminë e tij ndër të tjera ka deklaruar; Unë kam dhënë një deklarat pran gjyqtarit hetues me dt. 20.03.2002 dhe qëndroi pran asaj deklarate.Dëshmtari kishte deklaruar se ditën kritike deri në ora 8.30 min asgjë nuk kam ditur , në këtë kohë një djalë i Rashanit na ka treguar emrin e ka H mbiemrin nuk ja di , ai i kishte treguar djalit të mixhes me të cilin janë bashkë në TMK në Staritergë e djali i mixhes ka ardhur te unë dhe më ka treguar, dhe pastaj kamë shkuar në TMK në Stri Terg për ta lajmruar në telefon policin sespe unë telefon nuk kamë dhe as që punojnë telefonat te ne.Atje kam mbrri në ora 8.50 min dhe TMK e ka lajmruar policin në Mitrovicë, unë prisja aty ka ardhur një polic Amerikan dhe një përkthyes dhe policia ka ardhur ne oren 9.15 min dhe me ta kam shkaur te vedni i ngjarjes, kufomen i pari e kishte p[arë H dhe më shumë nuk di për këtë rast.

*2.Dëshmitari anonim ‘T...’* , është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit anonim i vendosur në një zyre të mbyllur për mos me u identifiku nga të pranishmit dhe i është ndryshuar zëri i cili në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 19.10.2023 i cili ka deklaruar; Mbes plotsisht pran deklaratës sime të dhënë me dt. 15.03.2002 dhe se dylbit nuk i posedoi dhe se është rast i ndodhur para 20 viteve dhe nuk më kujtohet modeli i dylbive dhe unë i kam ndrru më teper se 10 pal dylbi. Dylbit janë dëmtaur nga fëmijët dhe nuk i posedoi. Në pyetjen e mbrojtësit ë të pandehurit

se ju në deklarinimin me 15.03. 2002 keni deklaru; se dylbit me te cilat kanë shilkuar ngjarjen më kanë humbur për afersisht para një muaji “ cila është e verteta nga ajo që sot e thoni? Përgjigjet se për shkak se me dylbi është dal me zyrtaret policor në shiqim të vendit të ngjarjes dhe pas kësaj kohe janë dëmtaur dhe janë humbur dylbit .

Dëshmitari anonim me dt. 15.03.2002 kishte deklaruar; ditën kritike ishte e diele dt. 03.03.2002 jamë zgjuar heret në mëngjes në oren 4 e 30 min me qëllim të shkoj në mal për të prer thupra e për ta bërë një gardhë rreth shtëpis sime. Jmë zgjuar aq heret sepse nuk dëshiroja të vrehem nga roja e malit, rojtar kryesor është S.J i Koshtovës i cili vet më ka leja por në fshtësi që moas ta dinë rojet tjera, jamë veshur me tesha, kam marr me veti një sopat dhe jë pal dylbi të cilat i marrë me veti gjithëmon, shpesh i bajë edhe në qytet ndersa atë ditë me qëllim që të shiqoj mos po vjen ndonjë roje pylli, dylbit janë të vogla me vete e mora vllaun tim B.. që është më i vogel se unë për të ndihmuar rreth preresjes së thuprave më shpejtë. Jemi nis nga shtëpia në oren 4 e 30 min jemi ndal në një llugë te vendi i quajtur “Qershia e Kurtit” ku u ulum për të pushuar pakë për të ndezur nga një cigare dhe njëkosisht për të shiquar me dylbi terenin për rreth sespe prej aty ka dukshmëri të plotë, e tërë sipërfaqja dhe ky vendë ku jemi nal është karshi vendit të ngjarjes nën vijen ajrore rethë një kilometer, u ulum e ndezem nga një cigare, e dezëm prap edhe nga një tjetër dhe njëkosisht i nxjera dylbit dhe vëzhgoja terenin mos po shohë ndonjë pylltar, oren e kisha me veti në xhep, orë të dores. Në atë moment e kamë parë në breg kur është dal i ndjeri H.A dhe në afersi të shtëpis së Qerkinit, dhe me dylbi shumë mirë e identifikova H.A sepse në atë moment isha duke shiquar me dylbi mos po shoh ndonjë pylltar, ai ecte rruges për me dal në asfalt te xhamia e Vidishiqit ku pritet autobusi, ecte normal, kishte veshur një jelek të shushkavacit, pa mange dhe të zi dhe përfundi tij nja xhemper me mangë të gjata i cili dallohet prej jelekut dhe për shkak të ngjyres, pantollat mer sa mundë të shihja nga ajo posit ikishte sit ë përhimtë, prej shtëpis sime deri në atë vendë me ecë bukur shpejt bëbë një orë, ne kemi shku ngadal sepse ishte terr dhe u ulum aty të prisnim edhe që të zditet, kur është dal H.A ishte drit edhe hiq pa dylbi dukej bukur largë, prej ati bregu që e pashë H.A nuk ka ecur ma shumë se tre minuta bile vllaut i thashë se H.A po e shohë me dylbi sigurisht po shkojka në punë, ai ma kthu po se edhe të dieleve H.A punon, H.A ka punuar përball stacionit të autobusve kun ë një tezg të vogel ka shitur gjera të imta.E pash H.A duke ecur dhe pastaj dylbit i drejtova në anë te tjera që të vëzhgoi as që kam mund të mendoj se H.A do ti ndodhë gjë e keqe,bile vllaut i thashë në shaka ta thrasim H.A të na ndihmoi me pre thupra se po të paguaj e në punë mos shko fare dhe në atë moment prap i kam drejtuar dylbitë në drejtim të H.A i cili ecte ngadal, papritmas prek një grope në vendin e ashtuquajtur “mi stan” në largësi jo më shumë se 15 metra prej H.A, pasi që H.A duke ec rrugës i ka kaluar, ata nga mrapa kanë dal shpejtë prej asaj grope dhe kanë shti me automatik në H.A,



nga mbrapa unë isha në atë moment duke vëzhguar H.A dhe ata persona me dylbi dhe i pashë duke shtënë. Dy prej tyre kanë qenë me automatic, F.A dhe një person tjetër ka qenë me ta. V.A nuk i pash asgjë në dorë. Kanë shtënë rafal që të dytë, krisma e automatikut bënte në mënyrë të ndërprerë “këërrr, tak, tak-tak” disa herë, ishte e pa mundur me i numëru të shtënat dhe kanë shtënë nga pozita vertikale e tyre në këmbë, në drejtim të shpinës së H.A. Kur e kanë goditur plumbat në shpinë, H.A është munduar që të kthehet nga ata duke bërë një gjysmë rrethi dhe është rrëzuar me shpinë për toke në rrugë dhe mandej që të tretë i janë ofruar dhe V.A ia ka tërhjekur teshat lartë prej brezit duke ia zbuluar regjionin e stomakut dhe ja ka nxjerrë revolen H.A që e kishte pas me veti në brez, V.A raportiti atë revole dhe ja ka drejtuar në kokë dhe me atë revole ka shtënë dy herë në H.A. Kur shtiu në të V.A ishte në këmbë, por në afërsi shumë të afërt me H.A dhe menjëherë kanë ikur që të tretë. Në këtë moment e kam shiqur orën e cila ishte 06:10 minuta. Ata ikën në drejtim të objektit ushtarak ku ka qenë ushtria jugosllave e stacionuar dhe nonstop i kam vëzhguar sa kam mundur, kam shku në shtëpi me gjith vëllaun B..., mora dy pako cigare, dylbit i kisha me veti dhe tërë ditën kam vëzhguar po në atë drejtim që ikën duke u munduar të shoh se a janë mshefur dikund apo jo. Po atë ditë në mbrëmje rreth orës 18:00 para rënjës së muzgut, me dylbi i kam vërejtur në qendër të objektit, ata ishin lartë, unë isha në një pozicion poshtë prej tyre, por mund të shifja bile njëri prej tyre që e mbante automatin në krah, shiqonte me dylbi, por nuk mund ta identifikoja se cili prje tyre ishte ngase filloi të bjerë muzgu, gjithashtu tërë kohën kisha kujdes që ata të mos më vërejnë mua sepse nëse kishin me më pa, do ta kuptonin se i ka pa dikush, respektivisht që i kam pa unë dhe më vonë do të kisha pasoja, në shtëpi mbërrijta në orën 18:30 dhe atë ditë, tërë ditën nuk kam ngrënë buk, derisa unë vëzhgoja ngjarjen e vrasjes, vëllau B... mi kërkonte dylbit që të shikonte edhe ai nga kureshtja, por nuk ja pata dhënë sepse dëshiroja që ngjarjen ta përcjelli deri në fund pa ndërprerje në mënyrë që ti tregoj dikujt për realitetin që e shihja me sytë e mi. Të nesërmen në mëngjes prap jam zgjuar në ora 04:30 dhe shiqoja me dylbi dhe pas VC-ve të vjetra të shkollës në M..., i kam pa V.A dhe F.A vetëm këta dy, kur i pashë ora ishte 05:10, ishin fshehur dhe jqyrnin, F.A e kishte sërish automatin në dorë dhe shiqonte me dylbi, unë jam kthyer menjëherë në shtëpi sepse unë këtë vëzhgim e bëja prej llugës përmbi ship të Xh... e cila është mbi shtëpinë tonë rreth 100 metra dhe më nuk kam vëzhguar, por kam ndejtur në shtëpi kurse në mbrëmje diku rreth orës 20:30, prap këta dy i kam parë edhe pse ishte terr unë isha nën një dardhë të trashë që është afër shtëpëjav tona në kthesë në afërsi prej 5-6 metrav, i vëreja duke pirë duhanin, bile me duar lidhur grusht për mos me u duk gaca e cigarës, ata mua nuk më panë, hetuan se po eci, por ikën prej meje dhe shkuan në drejtim të shtëpisë se J... e cila është e djegur, në shtëpi u tregova se i pashë F.A dhe V.A dhe baba më tha që mos të dalim përjashta. V.A kur ka dal prej grope dhe që shtiu në trupin

e të ndjerit H.A e kam parë shumë mirë që ka pasur veshur një jakne të lëkurës ngjyrë hiri për afërsisht, farmerka sit ë kaltra, për këpucë nuk mund të them gjë, nuk ia kam vërejtur, jaknen e kishte pas të përthekuar dhe me jaka të ngritura, jakna e tij ishte e gjatë gjerë te xhepat e pantallonave, F.A kishte të veshur si në ngjyrë teget dhe ai tjetri për afërsisht të njejt për të cilin garantojë se është djali i axhes së tyre S.... A-i biri i A..., ka musteqe të vogla i cili banon në Vushtrri, afër varrezave të qytetit aty ai e ka shtëpinë, është i punësuar në TMK në Vushtrri, S.. është me trup më i gjatë se këta të dy dhe atë e kam njohur vetëm gjatë luftës gjersa ishim ushtarë të UQK dhe më kanë treguar se edhe atë e kemi kinse kusheri, pas luftës e kam pa edhe një herë në Prishtinë, kështu që e njohur mirë si figurë, në momentin kritik S... bash, bash mirë nuk ia kam parë fytyren, por në bazë të lartësisë së tij trupore dhe karakteristike dhe figurës së përgjithshme të tij jam i sigurt qind për qind se ai ishte me ta dhe edhe ai ka shtënë me automatic, kurse V.A dhe F.A shumë mirë ua kam vërejtur edhe fytyrat, bile F.A në kokë kish pas një kaqketë dhe ia dalloja edhe mustaqet, kurse V.A nuk ka pas mustaqe dhe as kapelë në kokë, F.A nuk ka pas allti, përveç automatikut me kaish krah qafe dhe V.A e kam parë kur ka shtënë me revole të të ndjerit H.A dhe kam dëgjuar vetëm dy të shtëna. Të shtënat tjera nga revolja nuk kam dëgjuar. Unë krismat e revolës dhe të automatikut i dalloj sepse kam qenë ushtar i UQK-së, bile jam në gjendje cdo lloj arme ta identifikojë sipas krismës. Edhe nëna ime me rastin e vizitës për ngushllime në shtëpinë e H.A, e ka dëgjuar një grua e cila është bija e M.A, e martuar në Vinarc e cila kish qëlluar po atë ditë në shtëpinë e familjes së vet në M..., emrin e ka H... apo I... nuk e di sakt, nëna ime e di për emrin e saj të sakt, e cila publikisht në atë rast kishte thënë se pas ngjarjes dy të bijtë e B... dhe i biri i A.... kanë trupuar afër shtëpisë së tyre dhe kanë shkuar në mal, por njerzit po frikësohen për tu paraqitur si dëshmitar. Kam dëgjuar se i kishin parë që të tretë dhe disa njerëz që i quajm “trepqali”, që banojn afër xhamisë së vjetër të M.... Dy lopë të V.A ia ka vjedhë njëfarë R... i Bajrit i cili kur është ardh me i vjedhë ato lopë e ka taku vëllaun tim B... dhe N... e F... Z.... dhe duke u thënë se a po më ndihmoni ti marrë këto lopë, të njejtit i ka bindur dhe lopët i ka dërguar në Bajr, një rën e kishte prerë, tjetrën e kishte shitur, 4-5 ditë para zbulimit se kush ia ka vjedh lopët V.A ka qenë në shtëpinë time si activist i fshatit për të ma regjistruar shtëpinë time për ndihma ndërtimore bile edhe më premtoi se do të më ndihmojë, asnjë njeri nuk na e ka dërguar rreth lopëve dhe me të nuk kemi qenë dhe nuk jemi në marrdhënie të kqëija, asnjëherë nuk kemi pasur kurrëfarë problem. Të ndjerit pasi që i ka pas fëmijët e vegjël i kam ndihmuar me bajt dru dhe punë të ngajshme, por gjithmonë me pagesë, kështu që ndaj tij dhe ndaj të pandehurve as nuk kam miqësi e as armiqësi. B... është 21 vjeqar. Është fakt që ka qenë atë ditë present me mua, por nuk besoj se është në gjendje të jap ndonjë dëshmi të fortë si unë sepse ai nuk ka pas dylbi e as që ia pata dhënë ndonjëherë që të shiqojë me to. Bile

vazhdimisht më pyeste se kush janë ata, por në ato momente nuk i tregoja, por këtë e kam bërë kur jam kthyer në shtëpi. Nuk kisha dëshiruar që në këtë proces të ma involvoni edhe vëllaun tim B... sepse në këtë rast ne do të ekspozohemi rrezikut më të madh si vëllëzër, mirëpo le të bëhet si të bëhet, por unë sa për vetën time kam vendosur që të dëshmojë për hirë të drejtësisë me shpresë se do të mbetem anonim sepse po ta merrë vesh familja e të pandehurve se kam dëshmu kundër tyre me siguri do të më ndodhë ndonjë e keqe dhe për ti fshehur gjurmët do të paguajn ndokënd të më vras, në të kundërtën gjithë këtë dëshmi do tja kisha thënë në sy V.A dhe F.A dhe kisha kërku prej tyre vetëm të më shikojnë në sy dhe tua tregojë se e di realitetin dhe se i kam parë duke e bërë vrasjen mirëpo besoj që as ju si gjykatë nuk do të pajtoheshit rreth pasojave ndaj meje dhe familjes. Unë e di se këto dy fjalje dhjetë vitet e fundit vazhdimisht kanë pas mosmarrveshje e acarime për arsye të ndryshme por sa më duket ceshtja e lopëve ishte motivi kryesor që erdhi deri tek vrasja. Nga vendi i ngjarjes mali është larg dy kilometra, me sa di unë derra të egër në mallet tona nuk ka, ndoshta ka pas ndonjë dimrit, por në këtë sezonë nuk besoj, përndryshe e di se F.A prej se është kthyer nga Gjermania, shite dru ndërsa nuk kam dijeni të ketë dal ndonjëherë për gjah për derra. Sa e di unë derrat e egër vrahen gjatë ditës jo natën dhe vetëm gjatë dimrit kur shihen tragjet e ecjes së tyre. Vendi ku ka ndodhur vrasja quhet në disa mënyrë “Mi Stan”, “te lugu i birave” dhe “Mi arë të Ukës”.

**3.Dëshmitari H.A3** me dt. 19.03.2002 ka deklaruar; Lidhur me Vrasjen nuk di asgjë po ashtu nuk di asgjë lidhur me mosmarrveshjet në mes tyre pasi që qe 6 vjet nuk kam qenë këtu isha në Gjermani. Një javë para vrasjes isha te vllau i ndjer H.A në M... dhe kam ndejtur diku deri rreth orës 20 dhe kam pas për të shkuar në punë në ndrrimin e tret, kam dalur nga shtëpia e tij dhe duke ecur rrugës shtëpia e fshatit në shpat i pash dy njerz të cilët më pytën ku isha, u tregova te vllau, ku po shkon, u thah në punë dhe ata në emër, hajt H... shko, dhe jam ndar prej tyre ishte terr dhe krejt dukeshin të zi, dhe në atë terr vrejta se edhe fëtyrat i kishin të mbuluara, me qka nuk e di. Pa më tutje njejt edhe dy persona tjerë në të njejtën mënyrë me te njejtat pyetje dhe përgjigje, edhe ata i kishin pas fëtyrat të mbuluara me të zezë, pasi që ishte terr, ishte e pa mundur ti njifsha edhe ata dy të parët edhe kta te dytë. Kam shkuar në punë pa problem dhe më H.A e ndjer më nuk jam takuar. Kur më thirrë ata dy të parët kam qenë shumë larg prej shtëpis së H.A, me metra nuk e di. As në bazë të zërit nuk mujta ti i njifsha. Kur më kanë thirr ata dy të parët, unë hecja rrugës, ata ishinë në shpat dhe distanca në mes meje dhe atyre ishte sa prej këtu e për afërsisht gjer te kapija që është në hyrje të oborrit të ksaj gjykate. Në M... kam shkuar në ditë e dilë ne ora 13,20. Ditën e hënë iu kemi dhënë bes, dhe prap tash 20 ditë. Ditën e hënë të gjithve iu kemi dhënë bes sepse për veç F.A sepse ai ishte në mal.

**4.Dëshmitarja Z.A** me datën 20.03.2002 ne polici ka deklaruar: së pari po filloj me tregua qysh V.A burrin tim e boni hajn, burri i imë iu përgjigj se lopët nuk ti kam marr duke i bërë be në thmi që lopët nuk ia ka marr. Kryetari i fshatit u kon V.A dhe P..., burri i im shkoj ti marr ndihmat e shtëpis dhe e kishte par P... i kishte thënë se kush më ka hjek prej ndihmave për shipa ai i kishte than se të ka hjekur V.A, burri i im i kishte thënë që qysh me më hjek prej nidhmave unë i kam 10 fëmij, kurfar të ardhurash nuk kamë dhe as kend në botën e jashtme nuk e kam me atë rast burri im është nervozuar shum në V.A edhe që e bëri hajn, dual në Mitrovicë dhe e rrahi V.A me stupc, për këtë rast V.A na ka dhanë bes, dhe kërkoj nga H.A që ti boj be me vllazni du me më ba be për lopët. H.A së bashku me vllazni bëri be me qitap se lopët nuk kanë vjedhur nga ata. Pasi që kanë bërë be V.A ka kërkuar që të mblidhjen njerzit nga të dy palët dhe këtë konflikt ta qesin në pleqni, dhe njerzit janë tubuar te xhamija e Haxhi Veselit në Mitrovicë dhe V.A ka kërkuar prej H.A ose 30.000 DM ose që H.A ta lëshon fshatin, ndersa H.A i është përgjigjur se fshatin nuk dëshiron me leshu me konstatim se as kend nuk e kam prekur në fëtyr ndërsa për të holla i kishte thënë se nuk kam, por qka kam të gjall le ta merr V.A vetëm kjo punë le të ndreqet, mirëpo V.A e kshte lëshuar pleqnin dhe kishte ikur në M... dhe njerzit ndërmjetesues kanë ardhur prap në M... kanë kontaktuar me V.A i cili u kishte thënë se kjo punë nuk ndreqet dhe unë atij nuk do t'ia fali dhe edhe pse i kemi dërguar njerzit ai besën e ndali duke iu thënë se ma bes nuk i japi. Burri i im 5 muj ka dal pa bes, nuk kishte qare pa dal, nuk kishim kurfar të ardhurash. Burri i jem armë nuk ka pas, ne nuk kemi mujt me u ngi buk e jo të bëjmë armë. Ditën e dile në ora 6 të mëngjezit H.A ka dal prej shtëpije si zakonisht me punue me veti e di që ka pas 100 apo 200 DM nuk e di bash sakt, aq s aka pas në kulet dhe është nisur për në Mitrovicë, për të punuar në pijac, te stacioni i autobusave, shitëte shtipalka e sende të tjera të imta dhe prej shtëpis sime unë i ndëgjova krizmat e automatit e më së mramti të alltis, i kishin dal dy vet V.A me F.A dhe e kishin vrrar dhe qka kishin dit zi në trup të tij kishin bërë thuaja se edhe e kishin masakruë. Kufomën e H.A unë e kam pa vetëm në fëtyrë, pash se fëtyrën e kishte me gjak, me sa mu duke në hund edhe në ball, shifej se një plum e kishte goditur në hund dhe nje tjetër në ball dhe pastaj kemi marr vesh prej Prishtine që e kanë kqyr mjekët, në shpindë i kishte marr 16 pluma. Unë H.A kurr armë nuk i kam pa dhe nuk di që ka pas armë. Ne dyshuam se e kanë vrrar V.A dhe F.A sepse vetëm ata i kanë thënë se to ta vrasin dhe se nuk do t'ia falin kurr rastin e rrafjes në Mitrovicë. Edhe V.A e ka ditë fort mirë që nuk kam as kend prej familjes sime më kanë vdekur të gjithë, kam vetëm fëmijët dhe qysh ka mujt ai këtë punë me e ba, me ua tha gojën 10 fëmijeve të mijë. Prej se janë kapur në fjal V.A dhe F.A edhe pse rruga është kah shtëpjjja jonë, për të shkuar në shtëpine tyre, gjithnjë ata i kanë ra tjetër rruge. Ditën kritike nuk i kam pa as F.A dhe

V.A se ishin ikë ata. F.A ma ka rrafur djalin tim 9 vjeqar në shkoll, këtë rast H.A e ka lajmruar edhe në polici dhe djali më ka mbetur me pasoja, nuk e di qka është ndërmarr kundër tij. Dëshmitarjas ne cilsin e të dëmtuarës deklaronë se i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj dy të pandehurve F.A dhe V.A. Gjakun nuk do t'ia fali kurr, dëmë nuk do të kërkojë prej tyre.

**Dëshmitarja është proceduar edhe në shqyrtimin gjyqësor dt. 08.11.2002 ku ka deklaruar; se** mbes ne teresi si ne procesverbalin Hep.nr.77/02 te dates 20 .03. 2002, me ndryshim se sot deklaron se ditën kritike i ka pa tre vete dhe une i kam njohur F.A dhe V.A, gjer sa personin e trete keta duhet te tregojne kush ka qene. Ne verjtjen e gjykates se pse sot deklaron se i ka pare keta persona duke ikur gjer sa tek gjyqtari hetues ka deklaruar se ditën kritike nuk i ka pa F.A dhe V.A se ishin ike ata, deshmitarja deklaron: se e verteta eshte kjo qe po deklaron sot. Burin ma kane vra menjehere mbi shtepi dhe une i kam ndegjuar krismat dhe menjehere pas krismave une kam dalur pas shtepije, bile femit e mi me thane "hinen apet shkiet se sa arma po nihet" pasi qe tane katundi ka ushtue Une i kam dalluar se krismat kane qene nga automati dhe alltijat. Une i kam pare duke ikur mbi shpija te M.... bregut. Une nga ky vend shtepin e kam karshi dhe nuk i ka me teper se 10 m. Une nuk i kam pare se cka kane pas veshur F.A dhe V.A pasi qe kane qene large por e dije se kane qene ne tesha civile. Pas mbledhjes se burave ne Xhamin e Haxhi Veselit H.A ka pas bese edhe 2 muaj dite, dhe pas ketij rasti e kemi qar nje person emrin e te cilit une nuk e dije por e dije se eshte nga fshati M...e dhe jetone ne fshatin Doberlluke, per te kerkuar bese mirepo ata bese nuk i kishin dhene, dhe ky person ka ardhe dhe mua personalisht me ka lajmruar se nuk i kane dhene bese. Une ne mbramie i kam treguar H.A se nuk ka bese dhe ai vetem me tha "hajer kofte". H.A pas ketij rasti ka derguar edhe persona tjere per te kerkuar bese por keta /V.A/ nuk i ka pranuar njerezit. H.A ka qene i detyruar per te dale me shite pasiqe i kemi 10 femi dhe nuk kemi te ardhura tjera. Pasi qe ka ndodhe vrasja familja e tyre nuk na kane derguar gjine per tu pajtuar, dhe as ne nuk dojme te pajtohemi, pasige kur nuk do t iu falim. Une due me dite se cili prej ketyre dyve e ka vra burrin tim dhe prap per se rati - per se dekti e ka gjujte apet. Une kerkoje gjithashtu qe polici i cili e ka mare kuletën te me tregoje se ku e ka mare kuletën, a e ka mare ne toke apo ne xhepin e H.A. Ne pyetje te prokurorit deshmitarja- e demtuara pergjigjet:

Ditën kritike nuk e kam percjelle H.A kur ka shkuar per te punuar, por kam qene fjetun dhe athere kur i kam ndegjuar krizmat jam zgjuar. Tane katundi i kane pare qe kane ike tre vete, dhe ne pyetje te prokurorit se te emron bile nje emer te nje personi i cili i ka pare e njejta deklaron: se i kam pa une, dhe nuk mund te them per dikend tjetër. Ka qene heret dhe te gjithë kane qene fjetun. Ne pyetje te avokatit Ismet Kabashit deshmitarja deklaron: nuk me kujtohet se tek gjyqtari hetues kam thene qe kemi dyshuar ne F.A dhe V.A se vetem ata e kane vrare H.A sepse kane

thene se kur-nuk do te ia falin rrahjen ne Mitrovice. Policia kur ka ardhe per me na i dorezue te hollat ne nje vend ka nenshkruar vajza e ime R..., pasi qe une kam qene e merzitur dhe nuk kam dite per veti. Diten kur mi kane dorezuar te hollat kane qene nji police i jashtem, nji police i yni dhe nje femer, dhe keto i kane dorezuar tenesermen kur ende ka qene kufoma ne shtepi. As sot e kesaj dite nuk me jane kethyer leternjoftimi, leja e kerrit dhe nuk e dije qe i kane kethye krejte paret. Diten kritike burri i im eshte nisur per te blere mall ne Prishtine dhe nuk e dije se a i ka pas 600 apo 400 euro me vehte. E dije se me ka pytur edhe policia se te holla ka pas bashkeshorti i im me veti por une nuk e dije se sa u kam thane pasi kam qene e habitur. Nese policia e ka gjete kuletën ne toke athere dyshoje se te hollat i kane mare F.A apo V.A, e nese i ka pas ne xhep athere e dije se ato i ka mare policia.

Dëshmitarja permirsohet dhe deklaroi se policia te hollat ia ka prure deri sa kufoma ka qene ne vendin e ngjarrjes e jo ne shtepi te cilen gje e konfirmon edhe prokurori se e ka degjuar deshmitaren kur ka thane, dhe te cilen e as mbroitia nuk e konteston. Kur kane ardhe policia per te mi pruar te hollat e kam ditur se H.A eshte i vrare. Policia fare nuk me ka ftuar per te dhene deklarate ne polici.

I bashkangjitem ndjekjes penale kunder V.A i cili ka qene shkakuar i te gjitha ketyre dhe F.A gjer sa nuk ushtroje kerkese per kompenzimin e demit.

**5.Dëshmitarja F.A1** në deklarimin e saj të dhënë në njësin rajonale të hetimit në polici me datën 05.03.2002 ka deklaruar se : për rastin që ka ndodhur të dielën nuk mund t’iu them diçka më tepër përpos çfarë kam ndëgjuar. Kam dëgjuar se një fqinj ishte vrarë dhe i dyshuar për këtë ishte kunati im , kur ka ndodhë vrasja burri im ka qenë në Mitrovicë. Është pyetur se ku ka qenë F.A, ajo ka deklaruar se F.A ka shkuar për në Mitrovicë për të punuar, dhe ka deklaruar tutje në pyetjet që i janë parashtruar se burri im nuk ka armë dhe as kunatin nuk e kam pa që ka armë , me familjen e viktimës kemi pasur marrëdhënie të mira . Është pyetur se e dini që V.A dhe F.A kanë bërë be se do ta vrasin viktimën, dhe kur është kthyer burri yt prej Prishtinës ,ka deklaruar se nuk di asgjë për këto thashetheme dhe se burri im është kthyer dje rreth orës 13:00, ka qendruar në shtëpi jo më shumë se 10 minuta , ka shkuar në Mitrovicë , për të kërkuar vëllaun e tij për të zbuluar se a është e vërtetë që ai ka shti në viktimën kemi dëgjuar thashetheme se F.A ka gjuajt në viktimën. Dëshmitarja në deklarimin e saj është pyetur se kur ka me u kthyer F.A ka deklaruar nuk e di.

**6.Dëshmitari J.Z** në shqyrtimin gjyqësor dt. 04.12.2023 deklaroi ; Unë nuk di asgjë sepse në atë kohë kam qenë duke jetuar në Dobërlukë , ndersa rreth kercnimit të N.Z nga F.A, atë ditë

kam qen në autobus ka qenë ditë bajrami , unë kam qenë me N.Z në karrik ulur dhe F.A ka qenë mbrapa dhe u përshendetum e dijë që diçka kanë folurn dhe për mua ka qenë të barabartë dhe unë ata i kam larguar F.A për most ë vazhdoi më tutje me fjalë.. Unë nuk kam njohuri dhe nuk kamë dëgjaur as nga këta dy emra e as nga dikush tjetër se i ndjeri H.A është kërcnuar me vdekje. Në autobus janë fjalos më duket rreth vjedhjes së lopve dhe unë nuk i kamë lanë më tutje me zgjat. F.A I ka thënë N... se mi ke vjedhur lopët. Dhe këto fjal janë kanë në autobus prej mbi Trepqe e deri në Mitrovicë.

Dëshmitari J.Z para Gjyqtarit hetues me dt. 21.03.2002 kishte deklaruar; Në autobus F.A mu drejtua se ‘‘kallxoi këtij kushes duke menduar ne N.Z me të cilin isha ulur se i kam bler dy lopë dhe a po vjen me i marrë ‘’, N... ja ktheu ‘‘ çka po thua’’ F.A prap I përseriti fjalët duke ju drejtua drejt N...; I kam bler dy lop a po vjen me i marrë’’. N... ja ktheu; shko thuaj ati që ti ka marrë’’. F.A i tha ;’’ vallha pa të prer thikë nuk e la ‘’. F.A I tha a po zbret në tokë ne Tunel të parë ta kryejm këtë ëpunë menjijher dhe ja ngjiti për jakne N... duke i thënë zbrit. Unë nuk e lash N.Z me abrit në tokë. Une i ndava duke ju thënë se është Bajram dhe nuk bëbë sot të bëni fjalë.F.A prap ju kërcnue me fjalë se ‘‘pa të prer me thikë nuk e lë’’ kur arritëm në Mitrovicë F.A zbriti kurse N.Z nuk e lejova të zbres nga autobusi.Deshtëm të shkojm në stacion të autobusve por F.A pasi që e pa se N... nuk zbriti hypi prap në autobus . Në stacion të autobusit F.A zbriti I pari , deshti të zbres edhe N... por unë I thashë nuk bon me zbritë se është marre me ju pa dikush në ditën e Bajrmait.Kështu që me të njetin autobus pa zbrit fare u kthyem prap te tregu I gjelbert dhe aty kemi zbritur. Nje ditë pas Bajramit vëllau i tijë S.A më ak thënë mos gabo ti me dhene dëshmi për mosmarveshjen ne mes këtyre dyve.

#### ***Administrimi i provave materiale në shqyrtim gjyqësor:***

Gjykata me qëllim që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë sa më të drejtë në këtë çështje penale në shqyrtimin gjyqësor, gjykata i procedoi provat e propozuara nga prokuroria në aktakuzë, dhe atë:

Procesverbali mbi vendshiqimin e Gjyqtarit hetues të Qarkut në Mitrovicë PNH.nr.12/02, dt. 03.03.2002,

Procesverbali mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes PNR.54/02, i dt.15.01.2003, nga ora 10:25 min.

Regjistri mbi gjurmët e gjetura në vendin e krimit nr.02-047 i dt.03.03.2002,

Legjenda mbi përshkrimin e gjurmëve të veprës penale në vendin e krimit, nr.02-047, dt. 03.03.2002,

Procesverbali i obduksionit të kufomës i përpiluar nga Instituti i mjekësis gjyqësore në Prishtinë, nr.33/2002 dt.04.03.2002,

Vërtetimi mbi pranimin-dorëzimin e armëve dhe gëzhjojave, nr.2002-BI- 30 i dt.01.04.2002,

Raporti i ekspertizës, nr.B-02/0... dt.01.04.2002; Rezultati i krahasimit, nr.B-02/0... dt.01.04.2002,;Memorandumi nr.2002-BI-30, dt.01.04.2002,Raporti i ekspertizës nr.B-02/0..., dt.01.04.2002,si dhe fotodokumentacionin e vendit të ngjarjes.

**1.Nga procesverbali mbi vendshiqimin** e Gjyqtarit hetues të Qarkut në Mitrovicë PNH.nr.12/02, dt. 03.03.2002,ku është përshkruar vendi i ngjarjes, është konstatu se ne anen e majt të rruges në drejtim të lagjes A... është parë i shtrirë trupi i pa jetë i të ndjerit H.A. Kufoma ishte e shtrirë në shpinë , këmbet drejt paralel dhe të dy duart i kishte të hapura dhe të shtrira në tokë. Kishte të veshur pantollona , gjmper, dhe një jakne pa krah ngjyrë të zezë. Në rreth kokës në tokë shihet puseta e gjakut ndersa në fytyr ne ballë mes të dy vetullave është një vrim nga predha e armës së zjarrit. Vrima e predhes shihet edhe në anen e djathtë të hundes dhe në anen e djathtë të fytit. Edhe në gjoks shihen vrima nga predhat e armes së zjarrit.Prej kufomes rreth 20 m larg rruges shihen gëzhjat e armeve të zjarrit. Gëzhjojat e revoles TT ishin afer kufomes ndersa ato te pushkes automatike AKM 47 ishin më largë kufomës. Janë gjetur 16 gëzhjoja të revoles ‘‘TT’’ dhe 26 gëzhjoja të pushkës së cekur.Larg dores se djathte te kufomes rreth nje metere u gjet nje predhë-projektil i revoles ‘‘TT’’.

**2.Nga procesverbali mbi akt-ekspertimin** mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes PNR.54/02, i dt.15.01.2003, nga ora 10:25 min ku ekspertët dhe atë eksperti mjeko-ligjor Flamur Blakaj dhe eksperti i ballistikës kriminalistike Hazir Kelmendi kanë dhënë mendimin dhe atë; Në trupin e tani të ndjerit H.A, janë konstatuar 10 (dhiete plage hyrëse-dalëse, të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhave Dy prej tyre kanë qenë të lokalizuara në regjionin e kokës, ndërsa tete të tjera në pjesë e sipërme të trupit. Prej tyre, plagë vdekjeprurëse dhe të papajtueshme (inkopatibile) me jetën, kanë qenë gjashtë dhe ate: dy ne regjionin e kokës dhe katër në kafazin e kraharorit, pika 1, 2, 5, 6, 9 dhe 10 (shih procesverbali i autopsise).

2. Duke u bazuar në trajektoret e predhave dhe në dëmtimet që janë të shkaktuara në pjesën e sipërme të trupit, si dhe në provat materiale ne vendin e ngjarjes (përreth viktimës), me besueshmëri të lartë mund te thuhet se janë shkaktuar në pozicionin në këmbë apo të përkulur të viktimes.

3. Bazuar në karakteristikat dhe veçoritë e plagëve (vrimave) hyrëse dhe dalëse në regjionin e kokës, në trajektoret e predhave, bazuar ne presencen e faktorëve plotësues të qitjes përreth



vrime hyrëse si dhe provave materiale në vendin e ngjarjes, me siguri të lartë shkencore mund të thuhet se: dëmtimi i përshkruar në pikën 1 të procesverbalit të autopsisë, si vrimë hyrëse, është i shkaktuar nga një distancë jo me e madhe se 50 cm. Pozita më e mundshme e viktimës gjatë shkaktimit të këtij dëmtimi duhet të ketë qenë pozita gjysëm e shtrirë.

Dëmtimi i përshkruar në pikën 2 të procesverbalit të autopsisë, si vrimë hyrëse, është gjithashtu i shkaktuar nga një distancë jo më e madhe se 50 cm. Pozita më e mundshme e viktimës gjatë shkaktimit të këtij dëmtimi duhet të ketë qenë pozita e shtrire (në atë pozitë si është gjetur viktimja në vendin e ngjarjes).

4. Bazuar në shpjegimet e të akuzuarit gjatë rekonstrukcionit të ngjarjes dhe bazuar në provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes, në karakteristikat e armëve të përdorura, bazuar në karakteristikat e demtimeve në trupin e viktimës si dhe gjurmëve të tjera të gjetura në vendin e ngjarjes mund të konstatohet me sa vijon: shpjegimi i të akuzuarit lidhur me ngjarjen kritike, nuk u përgjigjet provave materiale që në ditën kritike janë gjetur në vendin e ngjarjes; te shtenat nga pushka automatike janë bërë nga dy pozicione (shif skicën), por jo siç thotë i akuzuari kur kemi qenë ballë për ballë (i akuzuari tek kaçuba kurse i ndjeri në rrugë); konstatimin e lartpërmendur e konfirmon fakti se dy grupet e gëzhjave të pushkës automatike janë gjetur në pozicion që na jep të kuptojmë se i akuzuari nuk ka shtënë në viktimën, ashtu siç ai e shpjegon, por ka shtënë në drejtim të përafërt ku është gjetur viktimja në vendin e ngjarjes.(shif skicën).

Të shtenat nga revolet janë bërë nga dy pozicione dhe atë: grupi i parë i shtënave është kryer nga pjesa veriore e rrugës, dhe atë kur personi ka ecur në drejtim të rrugës, nën kënd të pjerrët me rrugën dhe në drejtim të viktimës; grupi i dytë i të shtënave është bërë prej rrugës dhe prej pjesës jugore të rrugës (kur është shtënë përreth viktimës).

5. Bazuar në dëmtimet në trupin e viktimës dhe provave materiale si dhe gjurmëve të gjetura përreth viktimës, mundësia që viktimja të ketë shtënë me revole është shumë e vogël, dhe atë për këto arsye: dëmtimet në trupin e viktimës janë të natyrës së tillë të cilat nuk kanë lejuar që viktimja të bëjë veprime ashtu siç shpjegon i akuzuari( duke shtënë gjatë gjithë rrugës, njeri në tjetrin derisa është rrëzuar i ndjeri); konstatimin se i ndjeri është goditur afërsisht në vendin se ku është gjetur, e konfirmon edhe fakti: bishti i cigars i llojit "Drina"( i njëjti lloj i cigars është gjetur në xhepin e viktimës) i gjetur pranë kufomës, bashkë me hirin(shpuzën) e padëmtuar na jep të kuptojmë se në momentin e të shtënave i ndjeri duhet ta ketë pasur cigarën në dorë ose në gojë.(shih fotografine).

3.Nga regjistri mbi gjurmët e gjetura në vendin e krimit nr.02-047 i dt.03.03.2002, ku vertetohet pozicioni i gëzhjojave të gjetura e të rënditura nga distanca kur është filluar gjuejtja me automatik e pastaj me revole e deri te trupi i viktimës.

4.Nga legjenda mbi përshkrimin e gjurmëve të veprës penale në vendin e krimit, nr.02-047, dt. 03.03.2002,ku përshkruhen gjurmët e gjetura dhe atë 26 predha të kalibrit 7.62 mm te pushkes automatike dhe 16 predha të kal. 7.62 mm të revoles.

Nga legjenda mbi përshkrimin e gjurmëve – vendit të gëzhjojave të gjetura gjykata verteton faktin se në distancën prej 29.90 metra nga trupi i viktimës është filluar të shtëhet me pushken automatike në drejtim të viktimës e duke ju ofruar deri në 17.25 metra me gjithsejt 26 predha, që verteton faktin se është shtënë me pushken automatike deri sa janë hargjuar plumbat e pushkes automatike duke lëvizur në drejtim të viktimës pra duke ecur.

Nga kjo legjendë Gjykata verteton faktin tjetër se pasi që është nderprer shtënja me armen automatike , ka vazhduar me shtënjën me revole dhe ate 16 predha duke filluar nga distanca 16.50 metra / që verteton faktin se vetëm një hap është ndrruar pasi i janë hargjuar plumbat e automatikut është nxjerr revolja dhe ka filluar gjuajtjen me revole / për të vazhduar duke ecur e duke shtënë me revole deri sa është ofruar viktimes në distancën 3.85 m .

Nga legjenda vertetohet fakti se në distancën nga viktimja prej 2.70 m në tokë është gjetur një projekttil i revoles 7.62 mm . Po ashtu është gjetur një projekttil nën tokë nën koken e viktimes e kalibrit 7.62 mm si dhe në tokë nën koken e viktimës është gjetur një predhë e pandezur e kalibrit 7.62 mm.

5. Nga procesverbali i obduksionit të kufomës i përpiluar nga Instituti i mjekësis gjyqësore në Prishtinë, nr.33/2002 dt.04.03.2002,vertetohet fakti se mjeku i ka zbuluar 12 plage në trup dhe 4 plagë në kokë . Të gjitha plagët janë shkrepur nga plumbat, më tutje dy plagë i kishte marrë në ballë, të cilat definitivisht nuk janë shkaktuar nga të shtënat. Nuk kishte lidhje në mes të dy plagëve. Mjeku tha, se është e mundur që trupi është rrzuar në ndonjë gurë ose këto shenja janë shkaktuar nga fuqia fizike me ndonjë mjet të panjohur. Vrimat në trup përbehen nga 6 plagë dalëse. Po ashtu në kokë ishin dy plagë hyrse. Të dyja të shtënat në kokë (në maje te kokës dhe në hundë) janë bërë nga një distancë e vogël. Mjeku e vertetoi se minimum 4 të shtëna ishin vdekjprurse ( dy të shtëna në kokë një e shtën në aortë nga ana e prapme dhe një e shtënë në mëlqi).Të shtënat në anen e perparme të djathtë të qafes ishte e qëlluar hyrse.Ndersa plaga dalëse e po të njëjtës të shtënë është pak më thellë në anen e djathtë të prapme në fillim të qafes.Mjeku i gjeti dhe i mati të gjitha plagët.Njësia e krim-teknikës bëri disa fotografi.

6.Nga,Vërtetimi mbi pranimin-dorëzimin e armëve dhe gëzhgojave, nr.2002-BI- 30 i dt.01.04.2002, 7.Nga , Raporti i ekspertizës, nr.B-02/0... dt.01.04.2002, 8.Nga , Rezultati i krahasimit, nr.B-02/0... dt.01.04.2002, 9.Nga,memorandumi,nr.2002-BI-30, dt.01.04.2002,10. Nga , Raporti i ekspertizës nr.B-02/0..., dt.01.04.2002,Gjykata verteton se; Arma e dorzuar me nr serik 1418... është e kalibrit 7.62 mm, pushk AK47, shkrep fishek 7.62 x 39 mm e prodhur në Kinë, ne gjendje te shkrepje ne menyre automatike dhe gjysëmatomatike.

Arma e dorezuar me numer serik-1418... eshte e kalibrit 7,62 mm, Pushke AK-47,

Arma e dorezuar pushke AK-47 me numer s serik-14184... Sambas rezultatit te testit te shkrepjes te gjitha pjeset funksionijne ne menyre te rregullt.

Arma e dorezuar me numer serik-D-33... eshte kaliber 7,62mm, Tokarev pistolete, shkrepje fisheke te kalibrit 7,62x25 mm, e punuar ne Jugosllavi, ne gjendje te shkrepje ne menyre gjysem-automatike.

Arma e dorezuar pistolete Tokarev me numer serik-D-33... Simbas rezultatit te testimit te shkrepjes te gjitha pjeset funksionone ne rregull.

Arma e dorezuar me numer serik- H-109... eshte e kalibrit 7,62 mm, pistolete Tokarev, shkrepje e fishek te kalibrit 7,62x25mm, e prodhuar ne Jugosllavi, ne gjendje te shkrepje ne menyre gjysem-automatike.

Arma e dorezuar pistolete Tokarev me numer serik- H-109... Sambas rezultatit te testit te shkrepjeste gjitha pjeset funksionojne ne rregull.

Rezultati i krahasimit: Te dorezuara 26 (njetegjashte) gezhoja te kalibrit 7,62x39 mm, dhe gezhojat e eliminuara (te shkrepura ne laborator per testim) te pushkes AK-47 me numer serik - 14184... jane egzaminuar dhe krahasuar me Stereo Makroskop per Krahasim sipas shenjave dhe kalibrit 7,62x39 mm, jane shkrepur nga AK-47 te dorezuar me numerin serik-14184... karakteristikave ne te eshte identifikuar se 26 (njetegjashte) gezhojat e dorezuara te kal 7.62 mm , janë shkrepur nga AK-47 të dorzuar me numrin serik 14184....

Lidhja reciproke ne mes te 26 gezhojave te kalibrit 7,62x39mm te dorezuara dhe gezhojave te eliminuara nga pushka AK-47 me nr, serik-14184...

Te dorezuara 15 (pesembedhete) gezhoja te kalibrit 7.62x25 mm dhe gezhojat e eliminuara jane egzaminuar dhe krahasuar me Stereo Makroskop per Krahasim, simbas te pistoletes Tokarev kaliber 7.62 mm me nr. serik - D-33... dhe eme nr. serik- H-109... karakteristikave dhe shenjave eshte identifikuar se: 6 (gjashte) gezhoja te kalibrit 7,62x25 mm te pistoletes Tokarev me numer serik- D-33.... Lidhja reciproke ne mes te 6 gezhojave te kalibrit 7,62x25mm dhe gezhojave te eliminuara te kalibrit 7.62 mm te pistoletes Tokarev- D-33... ;

Dhe 9 (nente) gezhoja te kalibrit 7,62x25 mm kane gene te shkrepura nga pistoleta Tokarev, kaliber 7,62 mm me numer serik -H-109..., Lidhja reciproke ne mes te 9 gezhojave te dorezuara te kalibrit 7,62x25 mm, dhe gezhojat e eliminuara te kalibrit 7,62 mm te pistoletes Tokarev me numer serik-H-109....

*11.Nga, fotodokumentacionin e vendit të ngjarjes vertetohet fakti ; Ku përmes 8 fotove duket trupi pa jetë i shtrire, pastaj shenjat e forenzikes te gëzhjojave , një bisht i cigares afer kokes së viktimës.*

**Nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes dhe mendimi i ekspertit të dylbive dt. 05.03.2024, vertetohet fakti se ;** Eksperti F.R , përmes dylbive të llojit 8x30 , nuk është e mundur të bëhet identifikimi i kolegut tonë V.K edhe pse është i njohur për mua sepse është koleg I imi , nuk mundë të vrehet fytyra dhe as çka ka në duar, sepse kolegu më pyeti përmes telefonit se çka kam në duar dhe unë nuk po mundem ta vrej se çka ka në duar.Ngjyra e rrobeve nuk mundë të përcaktohet vetëm në vija të trasha mundë të duken rroba të mbyllta. Si trup mundë të shihet edhe kur ulet dhe ngritet bazuar në faktin se tani dukshmëria është shumë e lartë , ndersa në mëngjes siç thuhet në ora 6 të mëngjesit kur ka ndodhur rasti ka qene shumë vështirë të identifikohen lëvizjet e personit.

Trupi gjykues ka kerkaur nga eksperti që nga kjo pikë të provoi me dylbi tjera më të avancuara me optikë 16x32 për të vërtetuar s ea mundë të bëhet identifikimi i personit edhe pse optika e këtyre dylbive është më e avancuar.

Eksperti ka deklaruar se prap se prapë nuk është e mundur të identifikohet edhe pse janë më të avancuara dylbit për kah shiqimi. Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se a mundë të identifikohet kolegu juaj në vednin ku është pozicionuar përgjigjet se nuk mundë të identifikohet.

***Paraqitja e mbrojtjes nga i pandehuri :***

***I pandehuri V.A*** deklaroi se zgjedhë të drejten e tij që të mbrohet në heshtje .

***Analizimi - vlerësimi i provave dhe besueshmeria e tyre:***

**Faktet e vërtetuara nga gjykata pas administrimit te provave:**

Pas administrimit të të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor dhe pas analizimit të tyre, gjykata në mbështetje të nenin 360 të KPP-së, provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor, Kjo Gjykatë e vetëdishme për kompleksitetin e këtij rasti , ju qas me përkushtimin e maksimumit professional duke administruar secilen provë dhe duke analizuar secilen provë – deklaramet e secilit dëshmitar brenda për brenda secilës, konsistencen brenda përbrenda secilës dhe pas përfundimit të secilës

deklarata si të veçant duke e nxjerrë përfundimin se cilin fakt e verteton e pastaj duke e krahasuar me secilen deklaratë të secilit dëshmitarë , duke vlersuar konsistencën në raport me këto deklarata e pastaj duke analizuar secilën provë materjale një nga një dhe duke i krahasuar me deklaramet e dëshmitarve dhe deklaramet e të dëmtaurve ka vërtetuar faktet si në vijim;

***Faktet e vertetuara me rastin e vlersimit të provave ;***

*Faktin se raportet në mes dy familjeve nuk ishin të mira qysh moti bile nga vitet e 90-ta , e duke vazhduar më pas deri në një moment kur kulmin e arrijnë për shkak të vjedhjes se bagetive.*

**Faktin se** mosmarrveshja kishte arritur kulmin lidhur me vjedhjen e dy lopëve . Këtë e konfirmon dhe e përshkruan shumë në detaje dëshmitarja Z.A;’’ V.A burrin tim e boni hajn, burri i imë iu përgjigj se lopët nuk ti kam marr duke i bërë be në thmi që lopët nuk ia ka marr’’.

**Fakti se F.A** lidhur me këto krer lop kishte bërë fjalë me N.A edhe në autobusin që shkon nga Trpça për në Mitrovicë dhe kishte nderhyr dëshmitari J.Z, vertetohet nga deklarimi i dëshmtarit J.Z ; ’’Në autobus janë fjalos më duket rreth vjedhjes së lopve dhe unë nuk i kamë lanë më tutje me zgjat .F.A I ka thënë N...t se mi ke vjedhur lopët. Dhe këto fjal janë kanë në autobus prej mbi Trepqe e deri në Mitroovicë’’ pastaj vazhdon ,në autobus F.A mu drejtua se ’’kallxoi këtij kushes duke menduar ne N.Z me të cilin isha ulur se i kam bler dy lopë dhe a po vjen me i marrë ‘’, N... ja ktheu ’’ çka po thua’’ F.A prap i përseriti fjalët duke ju drejtua drejt N...; i kam bler dy lop a po vjen me i marrë’’. N... ja ktheu; shko thua j ati që ti ka marrë’’. F.A i tha ;’’ vallha pa të prer thikë nuk e la ‘’. F.A i tha a po zbret në tokë ne Tunel të parë ta kryejm këtë punë menjihet dhe ja ngjiti për jakne N... duke i thënë zbrit. Unë nuk e lash N.Z me zbrit në tokë. Une i ndava duke ju thënë se është Bajram dhe nuk bëbë sot të bëni fjalë. F.A prap ju kërcnue me fjalë se ’’pa të prer me thikë nuk e lë’’ kur arritëm në Mitrovicë F.A zbriti kurse N.Z nuk e lejova të zbres nga autobusi. Deshtëm të shkojm në stacion të autobusve por F.A pasi që e pa se N... nuk zbriti hypi prap në autobus. Në stacion të autobusit F.A zbriti i pari , deshti të zbres edhe N... por unë i thashë nuk bon me zbritë se është marre me ju pa dikush në ditën e Bajrmait. Kështu që me të njetin autobus pa zbrit fare u kthyem prap te tregu i gjelbert dhe aty kemi zbritur’’

*Nga kjo provë gjykata verteton faktin se jo vetëm në këtë rast por edhe në disa raste tjera i pandehuri F.A ishte shumë agrsiv dhe shumë këmnngulës për tu ngatrruar dhe për të ardhur deri te pasoja e cila edhe erdhi.Këtë konstatim Gjykata e mbështet edhe në deklaramin e dëshmitares Z.A kur thotë’’ F.A ma ka rrafur djalin tim 9 vjeqar në shkoll, këtë rast H.A e ka lajmruar edhe në polici dhe djali më ka mbetur me pasoja, nuk e di qka është ndërmarr kundër tij’’*

**Fakti se V.A e kishte rrahur ne trgun e Mitrovicës tani i ndejri H.A vertetohet nga dëshmitarja Z.A kur nder të tjera thekson;’’burri im është nervozuar shumë në V.A edhe që e**

bëri hajn, dual në Mitrovicë dhe e rrahi V.A me stupc, për këtë rast V.A na ka dhanë bes, dhe kërkoj nga H.A që ti boj be me vllazni du me më ba be për lopët. H.A së bashku me vllazni bëri be me qitap se lopët nuk kanë vjedhur nga ata”.

***Faktin se ditën kritike a e ka parë dikush ngjarjen dhe besueshmeria e deklaramit lidhur me këtë fakt;***

Gjykata me kujdes analizoi dhe vlersoi deklaramet e dëshmtares Z.A – bashkshortes së të ndjerit H.A kur deklaron se; “prej shtëpis sime unë i ndëgjova krizmat e automatit e më së mramti të alltis, i kishin dal dy vet V.A me F.A dhe e kishin vrrar dhe çka kishin dit zi në trup të tij kishin bërë thuaja se edhe e kishin masakrue” pastaj “ Ne dyshuam se e kanë vrrar V.A dhe F.A sepse vetëm ata i kanë thënë se to ta vrasin dhe se nuk do t’ia falin kurr rastin e rrafjes në Mitrovicë” vazhdon “ Ditën kritike nuk i kam pa as F.A dhe V.A se ishin ikë ata”

Kjo dëshmtare në shqyrtimin gjyqësor dt. 08.11.2002 ku tani deklaron se; “mbes ne teresi si ne procesverbalin Hep.nr.77/02 te dates 20 .03. 2002, me ndryshim se sot deklaron se ditën kritike i ka pa tre vete dhe unë i kam njohur F.A dhe V.A, gjer sa personin e trete keta duhet te tregojne kush ka qene” pastaj ne verjtjen e gjykates se pse sot deklaron se i ka pare keta persona duke ikur gjer sa tek gjyqtari hetues ka deklaruar se ditën kritike nuk i ka pa F.A dhe V.A se ishin ike ata, deshmtarja deklaron: “se e verteta eshte kjo qe po deklaron sot”. “unë i kam ndegjuar krizmat dhe menjehere pas krismave unë kam dalur pas shtepije, bile femjet e mi me thane "hinen apet shkiet se sa arma po nihet" pasi qe tane katundi ka ushtue unë i kam dalluar se krizmat kane qene nga automati dhe alltijat, “Unë nuk i kam pare se cka kane pas veshur F.A dhe V.A pasi qe kane qene large por e dije se kane qene ne tesha civile”

Pastaj shton “ Ditën kritike nuk e kam percjelle H.A kur ka shkuar per te punuar, por kam qene fjetun dhe atëhere kur i kam ndegjuar krizmat jam zgjuar. Tane katundi i kane pare qe kane ike tre vete, dhe ne pytje te prokurorit se te emron bile nje emer te nje personi i cili i ka pare e njejta deklaron: “se i kam pa unë, dhe nuk mund te them per dikend tjeter”. Ka qene heret dhe te gjithë kane qene fjetun”.

Gjykata pas vlersimit të kësaj deklarate verteton faktin se e njëjta në brendin e saj është jo konsistente dhe se lidhur me faktin se a e ka parë se kush ka shtëpënë në viktimen ditën kritike rezulton se e njëja është e vertet se i ka dëgjuar krizmat dhe thotë; “ unë i ndëgjova krizmat e automatit e më së mramti të alltis”, por faktin se a ka parë dikën me rastin e dëgjimit të krismave ajo vet e thotë ;” Ditën kritike nuk i kam pa as F.A dhe V.A se ishin ikë ata ‘’, pra rezulton se dëshmtarja ju referohet të dëgjuarave dhe të përfolurave më vonë e jo se vet ka parë dikën ditën kritike kjo sepse ajo thotë “ Ne dyshuam se e kanë vrrar V.A dhe F.A sepse vetëm ata i kanë thënë

*se to ta vrasin''këtë e verteton edhe thënja e saj '' por kam qene fjetun dhe atëhere kur i kam ndegjuar krizmat jam zgjuar''.Jo konsistencen e deklaramit gjykata e nxjerr edhe nga fakti se ngjarja kishte ndodhur me dt. 03.03.2002 ndersa ajo ne deklaratën me dt.08.11.2002 tërsisht ndryshe deklaroi që jep me kuptuar se tani deklaramin e vet e mbështet në të dëgjuarat për rreth 5 muaj rresht pas ngjarjes.*

*Andaj bazuar në këto arsye gjykata ja fal besimin kësaj dëshitarje të dhënë menjher pas ngjarjes sepse gjërat i ka pas më të freskta dhe pa dëgjime nga jashtë e kjo edhe për faktin se lidhur me faktin se ka dëgjuar të shtënat kur cek '' Une i kam dalluar se krizmat kane qene nga automati dhe alltijat'', por jo edhe faktin se ajo e ka parë dikën ditën kritike.*

Në prizmin e këtij elaborimi Gjykata gjenë se i vetmi pretendues që e ka parë ngjarjen është dëshmitari anonim ''T...'' dhe tani gjykata me përkushtimin maksimal do të analizoi dhe vlersoi deklaramin e tij dhe atë në brendin e saj, pastaj në raport me rrethanat e kohës dhe mardhënjëv nderfinqjësore dhe do ta vlersoi në raport me deklaramin të tijë ditën kritike në raport me provat materjale e sidomos në raport me konstatimin e ekspertit të optikes-dylbive me rastin e konstatimeve në vendin e ngjarjes.

E para e çështjes gjykata verteton faktin se ngjarja e vrasjes kishte ndodhur me dt. 03.03.2002 rreth orës 6 të mëngjesit. Dëshmitari anonim deklarimin e tij e kishte bërë me dt. 15.03.2002 diku rreth 12 dite më vonë se sa ka ndodhur ngjarja, pra pasi që ishte kryer varrimi, pasi që veç ishte kryer te pamurit sipas traditave të rrethit. Gjykata gjene se nuk ishte kontestuese fakti se dëshmtari e njihte shumë në detaje terrenin e atij fshati, i njihte shume ne detaje raportet ndernjerezore i dinte problemet e ndodhura , pra ishte ne dijeni të të gjitha rrethanave të ndodhura deri në ditën kritike, por edhe faktin se për 12 dite nga nodhja e rastit kishte marrur shumë informacione për rastin edhe gjat varrimit edhe gjatë të pamurit sipas traditave këtë e verteton thënja etij kur thotë;'' Edhe nëna ime me rastin e vizitës për ngushllime në shtëpinë e H.A, e ka dëgjuar një grua e cila është bija e M.A, e martuar në Vinarc e cila kish qëlluar po atë ditë në shtëpinë e familjes së vet në M..., emrin e ka H... apo I... nuk e di sakt, nëna ime e di për emrin e saj të sakt, e cila publikisht në atë rast kishte thënë se pas ngjarjes dy të bijtë e Ba... dhe i biri i Ab.... kanë trupuar afër shtëpisë së tyre dhe kanë shkuar në mal, por njerzit po frikësohen për tu paraqitur si dëshmitar. Kam dëgjuar se i kishin parë që të tretë dhe disa njerëz që i quajm ''trepqali'', që banojn afër xhamisë së vjetër të M...it '', kjo verteton konstatimin e gjykates se i njëjti ka prirje ti ndertoit tezat e veta mbi të dëgjuarat.

***Jo konsistenca e deklaramit të dëshmtarit anonym’’T...’’ në raport me provat materjale gjegjesisht konstatimet e ekspertit të ballistikës dhe deklarimeve të tija.***

Gjykata gjene se dëshmtari anonym nder te tjera kishte deklaruar se ;’’ unë isha në atë moment duke vëzhguar H.A dhe ata persona me dylbi dhe i pashë duke shtënë. Dy prej tyre kanë qenë me automatic, F.A dhe një person tjetër ka qenë me ta. V.A nuk i pash asgjë në dorë. Kanë shtënë rafal që të dytë, krisma e automatikut bënte në mënyrë të ndërprerë “këërrr, tak, tak-tak” disa herë, ishte e pa mundur me i numëru të shtënat dhe kanë shtënë nga pozita vertikale e tyre në këmbë, në drejtim të shpinës së H.A’’ pastaj thotë;’’ Të shtënat tjera nga revolja nuk kam dëgjuar. Unë krismat e revolës dhe të automatikut i dalloj sepse kam qenë ushtar i UQK-së, bile jam në gjendje cdo lloj arme ta identifikojë sipas krismës.

Në kontekst të kësaj konstatimet e ekspertit të ballistikës janë ; Nga legjenda mbi përshkrimin e gjurmëve të veprës penale në vendin e krimit, nr.02-047, dt. 03.03.2002,ku përshkruhen gjurmët e gjetura dhe atë 26 predha të kalibrit 7.62 mm te pushkes automatike dhe 16 predha të kal. 7.62 mm të revoles. Nga legjenda mbi përshkrimin e gjurmëve – vendit të gëzhojave të gjetura gjykata verteton faktin se në distancën prej 29.90 metra nga trupi i viktimës është filluar të shtëhet me pushken automatike në drejtim të viktimës e duke ju ofruar deri në 17.25 metra me gjithsejt 26 predha, që verteton faktin se është shtënë me një pushke automatike deri sa janë hargjuar plumbat e pushkes automatike duke lëvizur në drejtim të viktimës pra duke ecur.

Nga kjo legjendë Gjykata verteton faktin tjetër se pasi që është ndërprer shtënja me armen automatike , ka vazhduar me shtënjën me revole dhe ate 16 predha duke filluar nga distanca 16.50 metra / që verteton faktin se vetëm një hap është ndrruar pasi i janë hargjuar plumbat e automatikut është nxjerr revolja dhe ka filluar gjuajtjen me revole / për të vazhduar duke ecur e duke shtënë me revole deri sa është ofruar viktimes në distancën 3.85 m .

Nga legjenda vertetohet fakti se në distancën nga viktimja prej 2.70 m në tokë është gjetur një projekttil i revoles 7.62 mm . Po ashtu është gjetur një projekttil nën tokë nën koken e viktimes e kalibrit 7.62 mm si dhe në tokë nën koken e viktimës është gjetur një predhë e pandezur e kalibrit 7.62 mm.

*Gjykata verteton faktin se nuk qëndron pretendimi i dëshmtarit anonim se janë përdorur dy automatik, kjo se nga legjenda e elaboruar vertetohet përtej çdo dyshimi se të 26 gëzhojat i përkasin një arme automatike e jo dy armë automatike siç pretendon ky dëshmtar anonim.*

*Gjykata vërteton faktin se është tërsisht i pa qëndrueshëm pretendimi i dëshmtarit anonim se vetem dy të shtëna janë bërë me revole dhe atë nga i pandehuri V.A kur i është ofru viktimës , këtë pretendim e demanton në tërsi fakti se në vendin e ngjarjes janë gjetur 16 gëzhoja të*



revoleve dhe atë 9 gëzhoja të një kalibri tieter që i takojnë një revoleje dhe 6 gëzhoja të revoles tjetër.

**Fakti se deklarimi i këtij dëshmitari se i ka parë dy përsona me dy automatik nuk qëndron e këtë e verteton edhe rezultati i kahasimit:** Te dorezuara 26 (njetetegjashte) gezhoja te kalibrit 7,62x39 mm, dhe gezhojat e eliminuara (te shkrepura ne laborator per testim) te pushkes AK-47 me numer serik -14184... jane egzaminuar dhe krahasuar me Stereo Makroskop per Krahasim sipas shenjave dhe kalibrit 7,62x39 mm, jane shkrepur nga AK-47 te dorezuar me numerin serik-14184... karakteristikave ne to eshte identifikuar se 26 (njetetegjashte) gezhojat e dorezuara te kal 7.62 mm , jane shkrepur nga AK-47 të dorzuar me numrin serik 14184.... Lidhja reciproke ne mes te 26 gezhojave te kalibrit 7,62x39mm te dorezuara dhe gezhojave te eliminuara nga pushka AK-47 me nr, serik-14184....

Te dorezuara 15 (pesembedhjete) gezhoja te kalibrit 7.62x25 mm dhe gezhojat e eliminuara jane egzaminuar dhe krahasuar me Stereo Makroskop per Krahasim, te pistoletes Tokarev kaliber 7.62 mm me nr. serik - D-33... dhe me nr. serik- H-109... karakteristikave dhe shenjave eshte identifikuar se: 6 (gjashte) gezhoja te kalibrit 7,62x25 mm te pistoletes Tokarev me numer serik-D-33.... Lidhja reciproke ne mes te 6 gezhojave te kalibrit 7,62x25mm dhe gezhojave te eliminuara te kalibrit 7.62 mm te pistoletes Tokarev- D-33... ; dhe 9 (nente) gezhoja te kalibrit 7,62x25 mm kane qene te shkrepura nga pistoleta Tokarev, kaliber 7,62 mm me numer serik -H-109..., Lidhja reciproke ne mes te 9 gezhojave te dorezuara te kalibrit 7,62x25 mm, dhe gezhojat e eliminuara te kalibrit 7,62 mm te pistoletes Tokarev me numer serik-H-109....

Nga kjo provë rezulton se i kemi një armë automatike AK-47 me nr, serik-14184...,dhe dy revole, njëra 6 gezhojave te kalibrit 7,62x25mm dhe gezhojave te eliminuara te kalibrit 7.62 mm te pistoletes Tokarev- D-33... dhe tjetra 9 (nente) gezhoja te kalibrit 7,62x25 mm kane qene te shkrepura nga pistoleta Tokarev, kaliber 7,62 mm me numer serik -H-109....

*Jokonsistenca e dëshmis së dëshmtarit anonim në raport me ekspertin e dylbive dhe kjo jokonsistenc, konsiston në faktet si në vijim; Dëshmitari kishte deklaruar se ‘‘ unë isha në atë moment duke vëzhguar H.A dhe ata persona me dylbi dhe i pashë duke shtënë. Dy prej tyre kanë qenë me automatic’’, lidhur me këtë rrethanë Eksperti F.R me rastin e rikonstruimit nga vendi i ngjarjes me rastin e shiqimit , përmes dylbive të llojit 8x30 , deklaroi se ‘ jo nuk është e mundur të bëhet identifikimi i kolegut tonë V.K edhe pse është i njohur për mua sepse është kolegj i imi , nuk mundë të vrehet fytyra dhe as çka ka në duar, sepse kolegu më pyeti përmes telefonit se çka kam në duar dhe unë nuk po mundem ta vrej se çka ka në duar.Ngjyra e rrobeve nuk mundë të përcaktohet vetëm në vija të trasha mundë të duken rroba të mbyllta’’. Për më tepër edhe me*

dylbi tjera më të avancuara me optikë 16x32,shume më të përsosura nuk mundë të identifikohet”.

Gjykata verteton faktin se prokuroria nuk ka siguruar një provë shumë relevante dhe atë dorzen e parafinës nga ana e viktimës për të mundur ti ipet përgjigje pyetjes se a ka shtënë viktima me revolen e tijë apo nga kjo revole ka shtënë dikush tjetër por edhe përkunder këtij fakti gjykata verteton faktin se nuk qëndron pretendimi i dëshmitarit anonym se është shtënë vetëm më një revole dhe atë dy her me revole të viktimës, por provat materjale siç u përshrua më lartë vertetojnë faktin se kemi 9 gëzhoja të shëna nga njëra revole dhe 6 gëzhoja të shtënë nga revolja tjetër.

Pra, nga kjo vertetohet fakti se është përdorur një armë automatike dhe një revole si dhe revolja e viktimës, armë këto të cilat edhe i ka dorzuar i pandehuri F.A i cili ishte denuar dhe e kishte vuajtur denimin e shqiptuar.

Nga skica e ekspertit te ballistkes në vendin e ngjarjes rezulton se në viktimen është filluar të shtihet me armen automatike në lartësin prej 29.90 m dhe atë në pozicionin duke ecur në drejtim të viktimës e deri sa janë hargjuar 26 gëzhojat, që rezulton se municioni i automatikut është hargjuar diku në 16 metershin dhe *ka vazhduar me shtënjën me revole dhe ate 16 predha duke filluar nga distanca 16.50 metra / që verteton faktin se vetëm një hap është ndrruar pasi i janë hargjuar plumbat e automatikut është nxjerr revolja dhe ka filluar gjuajtjen me revole / për të vazhduar duke ecur e duke shtënë me revole deri sa është ofruar viktimes në distancën 3.85 m.*

***Nga lidhja logjike e këtyra provave na rezulton se veprimet janë kryer nga një person e jo siç deklaroi dëshmitari anonim nga tre persona.***

Nga provat e analizuara si ato personale por edhe ato materjale Gjykata nuk ka mundur ta vertetoi përtej çdo dyshimi faktin e pretenduar nga dëshmitari anonim por edhe pretendimin e prokuroris e cila aktin akuzues e mbështet në deklarinimin e këtij dëshmtari se i pandehuri V.A me revolen e viktimës e ka goditur dy her të njëtin në kokë .

Për gjykatën kjo ishte dilema kryesore për faktin se prokuroria në fazën e hetimeve *nuk e kishte siguruar proven kryesore parafinen nga duart ose rrobat e të pandehurit V.A , por as nga duart e viktimës.*

*Lidhur me këtë fakt nga analizimi i të gjitha provave- dëshmit e dëshmitarve Gjykata verteton faktin se asnjëri nga dëshitarët nuk kishte parë të pandehurin ditën kritike përveq pretendimeve të dëshmtarit anonim për të cilin u dhanë shpjegimet dhe arsyetimet e hollsishtë më lartë.*

*Gjykata me rastin e analizimit edhe të provave materjale siç u elaboruan në hollsi vertetoi faktin se asnjë provë materjale nuk korrespondon me deklarin e dëshmtarit anonim.*

Provat materjale që gjykata ua ka falur besimin e plotë janë, fotodokumentacioni i vendit të ngarjes ku shihen vendi ku janë gjetur predhat ,renditja e tyre pastaj analiza e ekspertit të ballistikës pozicioni i gëzhjojave nga e cila ka dalur edhe konstatimi i pozitës se nga është shtënë dhe me çfar arme është shtënë deri ku është shtënë më armen automatike e pastaj nga ku ka filluar shtënja me revole , sa predha janë shtënë nga arma automatike e sa nga revolet e mbi të gjitha konstatimi I ekspertit të dylbive.

Andaj gjykata me rastin e vendosjes si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, provave materiale ua fali besimin, ngase te njëjtat nuk kishin ndonjë vrejte lidhur me besueshmrin e tyre, pra rruga ligjore e marrjes së tyre ishte në rregull, pastaj ishin konsistente në mes veti, formonin një koneksitet të logjikshëm të ngarjes, shumica nuk kishin kundërthënie mes njëra tjetrës në pjesën më të madhe, përkundrazi te njëjtat përputheshin mes vete dhe plotësonin njëra tjetrën dhe ne baze te te cilave gjykata ka ardhur në përfundim *se nuk ka prova që vertetojnë se i pandehuri V.A e ka kryer veprën penale : Vrasje nga neni 30pika 3 e LPK-së , lidhur me nenin 22 të LPJ-së .*

Gjykata, rikujton një parim kryesor të procedurës penale "*In dubio pro reo*", përcaktuar në nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se "mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor te të pandehurit dhe të drejtave të tij".

Andaj gjykata, të gjitha këto që u cekën më lartë i ka vlerësuar duke i ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "in peius" ndaj të akuzuarve duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (beyond reasonable doubt) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "in favorem" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Në prizmin e kësaj gjykata domosdo është e lidhur me dispoziten e nenit 257 par 3 të KPP-së ku përcakton decidivisht se ;''*Gjykata nuk e shpall fajtor të akuzuarin vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmtar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin*''.

Ky kufizim i përcaktuar përmes kësaj dispozite e ruan – mbronë rëndësin e parimit të gjykimit public – transparencën e gjykimit të një rasti dhe për këtë arsye edhe ka karakter kufizues kur kemi kësi situatë siç është edhe rasti konkret.

Si përfundim gjykata, ka konstatuar se nuk ka prova që e vërtetojnë faktin se i pandehuri V.A ka kryer veprën penale Vrasje nga neni 30ika 3 e LPK-së , lidhur me nenin 22 të LPJ-së.

Andaj, gjykata para së të marr aktgjykimin lirues për të pandehurin i analizoj dhe i vlerësoi të gjitha provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor përkitazi me këtë çështje penale konkrete dhe ndermori të gjitha veprimet e rekomanduara nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe mbi bazën e provave të administruara gjykata nga arsyet që kemi numëruar si me lart në rastin konkret vlerësoi se nuk ka prova që e vërtetojnë se i pandehuri kishte kryer këtë veprë penale siç pretendon prokuroria.

Lidhur me konfiskimin gjykata vërteton faktin se armët e dorzuara nga i pandehuri F.A i denuar për këtë rast ishin konfiskuar me atë aktgjykim.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Palët e dëmtuara sipas aktakuzës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil, në bazë të nenit 462 par.3 të KPP-së.

Nga si u tha me lartë e në mbështetje të nenit 363 par.1 pika 1.3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

**Departamenti për Krime të rënda**

**P.nr.154/2007 me dt.08.04.2024**

*Procesmbajtësja*

**Shukrije Selimi**

*Kryetari i trupit gjykues*

**Ali Kutllovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesa në afatin prej 30 (tridhjet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.